



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIJË DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË

Nr. 3657/1 Prot.

Tiranë, më 10.05.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1831, datë 09.02.2017.

SHOQËRISË “TIREX EXPLORATION” SH.P.K
Rr" Ibrahim Rrugova" Pallati 30, Shkalla B, Apart 4, Tiranë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “TIREX EXPLORATION” sh.p.k, e cila është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1831, datë 09.02.2017, për mineralin e bakrit, në objektin “Rehovë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.1658, datë 22.04.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.3657, Prot, datë 22.04.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1831, datë 09.02.2017, për mineralin e bakrit, në objektin “Rehovë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë, sepse nuk ka respektuar kërkesat e legjisllacionit minerar, pasi subjekti ka ndërprerë aktivitetin minerar në objekt.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.1831, datë 09.02.2017, për mineralin e bakrit, në objektin “Rehovë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1831, datë 09.02.2017, për mineralin e bakrit, në objektin “Rehovë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

